

KONCEPT : GËRMIM ARKEOLOGJIK

**PROJEKTI : “RINDËRTIMI I GJIMNAZIT “GJERGJ KASTRIOTI”
INVESTITOR : UNDP ALBANIA**

2023

Digitally signed by
Mariqlen Meshini
Date: 2024.02.14
10:58:24+0200'



KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

KONCEPT GËRMIMI ARKEOLOGJIK NË KUADËR TË PROJEKTIT

«RINDËRTIMI I GJIMNAZIT «GJERGJ KASTRIOTI» DURRËS

INVESTITOR: UNDP ALBANIA

PROGRAMI : EU4SCHOOLS

Përmbledhje e lëndës

- 1. Përshkrimi gjeografik i zonës ku do të zhvillohet projekti**
- 2. Të dhëna mbi projektin**
- 3. Gjetjet rastësore gjatë monitorimit arkeologjik**
- 4. Hapësira ku do të kryhet gërmimi arkeologjik**
- 5. Metodologjia e ndjekur për gërmimin arkeologjik**
- 6. Paraqitje e përmbledhur e potencialit arkeologjik të zonës**
- 7. Rekomandime**
- 8. Bibliografi**

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

1. PËRSHKRIMI GJEOGRAFIK I ZONËS

Durrësi gjendet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë (**Fig.1**). Vetë qyteti ngrihet në pjesën jugore të një brezi kodrinor veri-jug, afro 11 km i gjatë (**Fig.2**). Këto kodra kanë lartësi që varion deri në 200 m mbi nivelin e detit. Në pjesën jugore, ku vendoset qyteti, kodrat kanë lartësi nga 59 m deri në 89 m mbi nivelin e detit. Për të ndërtuar qytetin janë përdorur shpatet e këtyre kodrave që zbresin deri në nivelin e detit. Qyteti i Durrësit paraqet një zhvillim të orientuar kryesisht drejt jugut (brigjet e Gjirit të Durrësit) dhe drejt lindjes (aty ku ndodhej kënetat, deri para tharjes në vitet 60 të shekullit të kaluar).



Fig.1-Hartë, pozicionimi gjeografik i Durrësit



Fig. 2-Qyteti i Durrësit dhe prapatoka. Hartë relievi

Ultësira Bregdetare, pjesë e së cilës është edhe Durrësi, në aspektin gjeologjik konsiderohet si pjesa më e re e Shqipërisë¹, duke u krijuar si tokë kontinentale në fundin e *Pliocenit* (5.33 – 2.58 milion vite BP) dhe kryesisht gjatë *Kuaternarit* (2.58 milion vite BP – në vazhdim). Më herët, përgjatë fundit të *Miocenit* (23.03 – 5.33 milion vite BP) dhe *Pliocenit* të hershëm (5.33 – 3.6 milion vite BP) në këtë territor shtrihej një det i cekët, në formën e një lagune. Me hapjen e

¹ M.KABO, Gjenezat e kënetave të ultësirës bregdetare (Në bazë të të dhënave historiko-arkologjike), *Studime Gjeografike* 5, 1994, 179-203.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

ngushticës së Gjibraltarit, si pasojë e lëvizjeve tektonike, ujërat e oqeanit Atlantik vërshuan në Mesdhe, duke ngritur nivelin edhe të detit Adriatik. Në këtë kohë ky det mbuloi pothuaj të gjithë Ultësirën Bregdetare të sotme. Nën det u grumbulluan molasa detare neogjenike mbi molasën miocenike. U formuan gjithashtu shtresa konglomeratesh e ranorësh, pasuar nga argjila. Përgjatë *Pleistocenit* lëvizjet ngritëse sollën krijimin e steres dhe mbi ujë dolën, në trajtë ishujsh, një radhë antiklinalesh kodrinore, ndër të cilat edhe kodrat e Durrësit dhe Rodonit. Ndërkohë që në sinklinalet (të ndara nga antiklinalet) vazhdonte depozitimi i aluvioneve nga lumenjtë duke sjellë gradualisht edhe daljen e tyre mbi ujë. Të tilla lëvizje të kombinuara mes tyre krijojnë laguna, të cilat me kohë mbusheshin, vija bregdetare shtyhej, e të tjera laguna pasonin. Lëvizjet ngritëse në Ultësirën Bregdetare u shoqëruan edhe me shkëputje tektonike duke i ngritur edhe më tej në lartësi, ndër të cilat Mali i Durrësit dhe Kepi i Rodonit janë shembuj të spikatur. Përgjatë *Kuaternarit*, ndërsa vazhdonte procesi i krijimit të Ultësirës Bregdetare, prurjet e ngurta të lumenjve shtynin vazhdimisht vijën bregdetare drejt perëndimit. Gjatë procesit të daljes mbi ujë të Ultësirës Bregdetare krijoheshin peisazhe karakteristike, pjesë e së cilave ishin edhe *paleokënetat*. Këto ishin mbetje të gjireve detare që hynin në brendësi të Ultësirës në pjesët më të ulta të relievit. Në Durrës u krijua një lagunë si rrjedhim i krijimit të tombolës së dyfishtë nga bashkimi me tokën i ish-ishujve pliokuaternarë të Kepit të Palit dhe të Malit të Durrësit. Fillimisht u krijua një gji detar i cili, më pas, u shndërrua në një lagunë. Dobësimi i lidhjeve me detin e transformoi atë në kënetë. Krijimi kënetave, përfshirë edhe atë të Durrësit, ka ardhur si pasojë e një serie faktorësh. Mbushja e shtretërve të lumenjve me aluvione që sillte daljen nga shtrati dhe ujrati e ndenjura ktheheshin në kënetë. Ngritja intensive e territorit nga lëvizjet neotektonike lidhet me faktorë natyrorë por edhe njerzore (p.sh. asgjësimi i pyjeve). Depozitimi i aluvioneve në grykëderdhjet e lumenjve krijonte ledhe, duke u kthyer në pengesë për rrjedhjen e lirë të ujërave, si dhe një serie faktorësh të tjerë gjeologjikë.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

Ndërkohë, nuk duhet të harrojmë edhe rëndësinë e detit Adriatik dhe të proceseve të tij formuese në raport me gjeomorfologjinë e Durrësit². Adriatiku jugor (njohur edhe si Pellgu Shqiptar) ka origjinë sedimentare, me strukturë asimetrike. Në perëndim ai bie në kontakt me platformën Apuliane, ndërsa në lindje kufizohet nga strukturat e mbihipura të Albanideve e më në veri të Dinarideve. Në jug, ky pellg, vazhdon në shelfin detar shqiptar dhe në stere, në Ultësirën Adriatike të Shqipërisë, duke përfshirë edhe Durrësin e rrethinat e tij. Morfologjia e shelfit detar shqiptar të Adriatikut paraqet tre breza, prej të cilave vetëm i sipërmi paraqet interes për ne. Bëhet fjalë për cektinën bregdetare, që është një ultësirë e sheshtë bregdetaro- shelfore, ku grumbullimi i sedimenteve që nga *Pleistoceni* deri sot realizohet kryesisht nga veprimtaria e dallgëve. Ky brez shtrihet afërsisht deri në thellësinë 50 m. Përgjithësisht bregdeti i Durrësit i takon tipit të ultësirave aluvialo-detare, me karakter grumbullimi të sedimenteve. Ndërsa Kepi i Palit dhe Kepi i Rodonit janë sektorë ku mbizotëron gërryerja. Sektorët me mbathje dhe grumbullim sedimentesh janë cektina, ndërsa sektorët me gërryerje kanë thellësi më të mëdha³. Bregdeti shqiptar i Adriatikut cilësohet si një kufi dinamik stere-det, tipike aluvialo-detare, që ka marrë tiparet e sotme në paspliocen dhe që është mbushur me materialin aluvial të sjellë nga rrjeti lumor i formuar në etapën neotektonike të Albanideve. Në rajonin e Durrësit bregu ka përparuar drejt steres në kuaternarin e hershëm⁴, gjatë epokës pasakullnajore më të vonshme (*Alerodiane*), duke marrë formën e sotme. Në det, nën sedimentet e imta aleurotiko-deltinore takohen zhavorre e rëra trashamane që mbulojnë me tejvajtje (transgresion) relievin e vjetër të shkëmbinjve rrënjësorë *Tortonianë*, që përbënin vijëne lashtë bregore të *Pleistocenit*. Krahasuar me gjetjet arkeologjike dhe realitetin e terrenit të sotëm, këto të dhëna përputhen me praninë e shkëmbinjve konglomerat që shfaqen ende mbi nivelin e sipërfaqes së detit si dhe me shtresat masive të zhavorrit, të zbuluara më herët përgjatë gërmimeve arkeologjike në ekstremin jugor të qytetit, përballë hyrjes kryesore të

² A.PAPA, Gjeologjia dhe gjeomorfologjia e pellgut dhe e shelfit shqiptar të Adriatikut, *Studime Gjeografike* 1, 1985, 96-116.

³ A.PAPA, Gjeologjia dhe gjeomorfologjia e pellgut dhe e shelfit shqiptar të Adriatikut, *Studime Gjeografike* 1, 1985, 111.

⁴ A.PAPA, L.PENGILI, Gjeologjia e shelfit detar te rajonit te Durrësit, Ref. Ses. Shk. Inst. Naftes, Fier 1981.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

portit. Me rëndësi në krijimin e gjeomorfologjisë së territorit të Durrësit janë lëvizjet tektonike gjithashtu, të cilat janë ende edhe sot aktive⁵. Të tilla lëvizje i përmendëm edhe më lart. Relievi fushor dhe kodrinor në pellgun e Durrësit, të cilat i përkasin *Kuaternarit* të mesëm, është ende sot në formim. Ky territor konsiderohet ndër rajonet me sizmicitet të lartë në vend. Bazuar në disa matje gjeodezike të realizuara në vitet 1987-1990 është vërejtur se të gjitha pikat e matura kanë çvendosje vertikale negative (ulje). Më e theksuar kjo lëvizje vihet re në pjesën fushore, ndërsa në pjesën kodrinore janë më të vogla. Në vetë qytetin e Durrësit këto ulje shkonin deri në 28.8 mm, pasuar nga zona e plazhit të Currilave. Kjo vatër uljeje është shpjeguar me fundosjen e Gjirit të Durrësit dhe shkëputjen tërthore Durrës-Rrashbull. Në territorin e ish- kënetës vlerat e uljeve zvogëloheshin nga qendra drejt periferisë. Në përgjithësi tendenca e strukturave për ulje orientohej JL-VP. Brezi kodrinor i Durrësit pikën më të ndjeshme të uljeve e kishte tek hidrovari (Portëz) dhe më e madhe në Currila. Kjo tendencë lidhet me shkëputjen tektonike të krahut perëndimor të strukturës antiklinale të kodrave Durrës – Portëz. Një faktor me rëndësi për të kuptuar tiparet e bregdetit të Durrësit dhe evoluimin e tij ndër shekuj lidhet me zhvendosjet e rrjedhës së ulët të lumenjve, në rastin konkret me atë të Shkumbinit dhe Erzenit. Vlerësohet nga studiuesit se Shkumbini derdhej në gjirin e Durrësit në periudhat prehistorike ose antike. Vetë krijimi i plazhit të Durrësit mendohet se ka ardhur si pasojë e prurjeve të ngurta që vetëm një lum i madh si Shkumbini mund të sillte⁶. Ndërsa pjesa veriore e territorit të qytetit, ka pasur ndikimin paralel të lëvizjeve neotektonike ngritëse dhe të akumulimit të fuqishëm të Erzenit⁷.

⁵ P.LUKA, Disa të dhëna për lëvizjet vertikale të kores së tokës në territorin e Durrësit nëpërmjet metodave gjeodezike, *Studime Gjeografike* 6, 1995, 271-283.


⁶ M.KABO, Mbi ndryshimin e rrjedhjeve të poshtme të lumenjve që përshkojnë ultësirën bregdetare gjatë epokës historike, *Studime Gjeografike* 4, 1990, 193.

⁷ P. LUKA, Disa të dhëna për lëvizjet vertikale të kores së tokës në territorin e Durrësit nëpërmjet metodave gjeodezike, *Studime Gjeografike* 6, 1995,273.


KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

UNDP ALBANIA, me programin e tyre « EU4SCHOOLS », synon të kryejë punime në një territor me sipërfaqe trualli 4367 m² dhe gjurmë objekti 1197 m². Projekti në fjalë ka si qëllim përmirësimin e kushteve në të cilat kjo godinë ndodhet pas tërmetit të vitit 2019 dhe është pjesë e projektit : **Rindërtimi i 5 qendrave mesimore në Durrës dhe Kavajë, Faza 2, Loti 2 me financues UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillim)**. Projekti i propozuar do të jetë gjithsej 4 kate, me 1 kat nën tokë dhe një sipërfaqe totale e brendshme e shkëlshme prej 4507 m². Shkolla do të ketë kapacitet për maksimum 762 nxënës, nga klasa e parë deri në klasën e tretë të shkollës së mesme. Janë 23 klasa me 30 nxënës, plus 4 paralele me 18 nxënës dhe laboratorët përkatës. Do të ketë një gjimnaz të madh dhe një sallë të vogël palestër për të gjithë nxënësit por mund të jenë edhe në shërbim të komunitetit. Në shërbim të komunitetit do të jetë edhe auditori në katin përdhësë.



KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK



KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK



Fig. 6- Pamje 3D Gjinnazi ‘GJERGJ KASTRIOTI’

3. GJETJET RASTËSORE GJATË MONITORIMIT ARKEOLOGJIK

Konform legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi, me datë 20/09/2023 filloi gërmimi për realizimin e projektit për rindërtimin e shkollës Gjergj Kastrioti. Gjatë punimeve në thellësinë 4.5 metër u evidentua një zonë e shtruar me mozaik dhe disa struktura muresh. Mozaiku mendojmë se shtrihet në një sipërfaqe rreth 25m², është cilësor, pra ruhet në gjendje shumë mirë. Pas një pastrimi të shpejtë që ju bë një pjese të mozaikut vërejmë se kemi të bejmë më një ndërtim unikal të panjohur në qytetin e Durrhahut për periudhën e shekujve të parë m.Kr. Gjithashtu po në këtë zonë janë evidentuar dhe disa linja muresh, ku pas gërmimit arkeologjik do të jemi në gjendje të kuptojmë dhe situatën e kësaj zone. Nga ana jonë menjëherë u bllokua

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

vazhdimi i punës së investitorit. Siç dhe kemi treguar në informacionet e mëparshme në këtë thellësinë (4 m) janë zbulua trakte muri me gjatësi 1.3 m dhe gjerësi 0.47 m Nisur nga teknika e

Mariglen Meshini
Digitally signed by
Mariglen Meshini
Date: 2024.02.14
10:58:24+02'00'

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

punimit të murit dhe gjetjeve arkeologjike jemi shprehur se kjo linjë muri mund të datohet nga shek. I para krishtit deri në shek.I m.Kr.



Fig.7 Gjatë evidentimit



Fig.8 Gjatë evidentimit



Fig.9 Gjatë evidentimit




Fig.10 Gjatë evidentimit

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

4. HAPËSIRA KU DO TË KRYHET GËRMIMI ARKEOLOGJIK

Zona ku do të kryhet gërmimi arkeologjik përfshin gjurmën ku do të ndërtohet Shkolla “ Gjergj Kastrioti”, Durrës. 70% e gërmimit në këtë gjurmë ka arritur kuotën sipas projektit 6.75 m thellësi. Duke qënë se në pjesën e mbetur kemi hasur në gjetje arkeologjike si Mozaik, linja muresh, fragmente afresku, pjesë kolonash, të cilat shtrihen në zonën e pa gërmuar deri tani, është e nevojshme që e gjithë kjo zonë duhet ti nënshtrohet gërmimit arkeologjik për të kuptuar më mirë këtë situatë pasi zona shfaq potencial të lartë arkeologjik. Gërmimi do të ndahet në dy zona : Zona me gjetje linjash muri dhe Zona me Mozaik. Gërmimi do të kryhet paralel në të dy zonat për të shpejtuar procesin e gërmimit arkeologjik. E gjithë zona e gërmimit mund të përfshijë 1500 m³ - 1800 m³ heqje dheu për të arritur në kuotën 6.75 m thellësi. Sipëfaqja e gërmimit paraprakisht mendohet të arrijë në 560 m².



KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

Gërmimi i mozaikut

1- SITUATA EKZISTUESE

Situata ekzistuese e deri tanishme na paraqet fragment mozaiku gjeometrik, floreal i cili ndodhet në veri-perëndim të sheshit. Ky mozaik deri tani shfaqet me një punim të cilësisë së lartë.

2- NDËRHYRJET QË DO TË KRYHEN

- Aktualisht nuk njihet gjurma e plotë e shtrirjes së mozaikut.
- Nëse mozaiku do të vazhdoj shtrirjen e tij në pjesën ku aktualisht është e mbuluar nga dhërat, gërmimi i tij do të vazhdoj pasi investitori të marrë masa për sigurinë e zonës e cila aktualisht ka rrezikshmëri të lartë të shembjes së dherave.
- Gërmimi i mozaikut do të kryhet nga specialist të fushës për këtë proces.
- Gjatë gërmimit në gjithë këtë zonën ku shtrihet mozaiku do të kryhet procesi i sitjes së dheut.
- Do të kryhet pastrimi i tij sipas standarteve më të larta për mozaikë.
- Të gjitha pjesët e dëmtuara do të ruhen sipas rendit përkatës.
- Pas përfundimit të gërmimit të mozaikut do të kryhet dokumentimi i tij me fotogrametri, planimetri 3D, vizatim fizik në letër kalk me përmasa reale , dron, etj.

3- RREZIKSHMËRIA

Pasi të jetë kryer gërmimi i plotë i këtij mozaiku, mendojmë që do të jetë i nevojshëm konservimi i tij, duke qënë se kushtet atmosferike dhe habitati i tij do të ndryshojne me zbulimin e plotë. Kjo si pasoje mund të sjellë dhe dëmtimin e tij.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

5. METODOLOGJIA E NDJEKUR PËR REALIZIMIN E GËRMIMIT ARKEOLOGJIK

Metodologjia e ndjekur gjatë realizimit të gërmimit arkeologjik në zonën e përcaktuar është:

Aktiviteti i gërmimit arkeologjik do të kryhet bazuar në "Rregulloren mbi kriteret e ushtrimit të arkeologut. Kriteret e gërmimit dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike", miratuar me Vendimin Nr.2, datë 30.01.2009 të KKA.

Çdo fazë e punës do të dokumentohet hap pas hapi, përmes dokumentimit grafik, fotografik, dixhital etj. Dokumentacioni bazë do të hartohet gjatë operimit arkeologjik në tekst, grafik dhe imazh.

Realizmi i gërmimeve do të bëhet i kombinuar, me arkeologë, ndihmës arkeologë, punëtorë dhe mjet mekanik me kovë pa dhëmbëza i tipit JCB dhe Bobcat.

Në grupin e punës do të përfshihen dhe specialist për gërmimin e mozaikut.

Për gjetjet arkeologjike do të angazhohen dhe specialistë laborant për analizimin dhe konservimin e gjetjeve si : Bronz, Hekur, Bakër, Kallaj, Argjend, Ari. Konservim i drurit. Konservim të qeramikës.

I gjithë dheu i cili do të gërmohet do të depozitohet brenda territorit të kantierit, i cili dotë kontrollohet për tu siguruar mos humbjen e gjetjeve të fragmenteve të ndryshme apomonedhave që mund të përmbaje siti.

Bazuar në këtë dokumentacion arkeologjik të përpiluar në terren, do të kryhen analiza dhe hartimi i raportit përfundimtar. Përpunimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të operacionit arkeologjik për dorëzim në Arkiv do të kryhet paralelisht me punën arkeologjike në terren dhe përfundon mbas tij, si dhe përfshin:

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

a) Kontrollimin dhe plotësimin e të gjithë dokumentacionit që vjen prej operacionit arkeologjik, si:

- Kartelat e Njësive Stratigrafike
- Vizatimet e dorës të formatit A3, A4 dhe ato në Kartelat (si vizatime të profileve etj)
- Raportet e matjeve me sistemin e koordinatave.
- Hartimi i listave të gjetjeve arkeologjike, të fotove dhe të vizatimeve.

Përpunimi i gjetjeve arkeologjike nëpërmjet, pastrimit, dokumentimit, regjistrimit, të gjitha këto sipas Rregullores dhe rakordimi i tyre me listat e dokumentacionit.

b) Katalogizimi i Njësive dhe i Gjetjeve arkeologjike në bazën e të dhënave:

- Regjistrimi i gjetjeve sipas njësive stratigrafike dhe datimi i njësive stratigrafike
- Katalog i gjetjeve te imta/te veçanta.

c) Digitalizimi i vizatimeve të dorës (planimetri, pamje dhe prerje profilesh, dhe për raste të veçanta edhe tredimensionale). Ato kryhen prej specialistëve me përvojë në përpunimin e vizatimeve të operacioneve arkeologjike.

d) Hartimi i Raportit të gërmimit, i cili kryhet nga arkeologu me aftësi redaktuese.

Të gjitha objektet arkeologjike të zbuluara gjatë gërmimit arkeologjik janë pronë e shtetit shqiptar në bazë të Ligjit Nr 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgimisë Kulturore. Regjistrimi dhe depozitimi i tyre kryhet konform dispozitave të këtij ligji. Materialet arkeologjike depozitohen pranë Muzeut Arkeologjik në DURRËS.

Kohëzgjatja e realizimit të gërmimit do të jetë me një periudhë prej 60 ditë pune (nuk përfshihen ditët me shi apo probleme të ndryshme që pengojnë punën).

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

Realizimi i raportit final dhe mbylljes së dokumentacionit do të kryhet brenda një periudhe minimale prej 20 ditë pune nga mbyllja e punës në terren.

Botimi i “Raportit Përfundimtar” është e drejtë ekskluzive e subjektit të licencuar që do të realizojë sondazhet.

Sipas këtij koncepti, gërmimi do të kryhet deri në thellësinë që kërkohet nga projekti 6.75 m.

6. POTENCIALI ARKEOLOGJIK I ZONËS.

Sheshi ku do të realizohet gërmimi arkeologjik gjendet në jug të qytetit të Durrësit, në zonën B të zonifikimit arkeologjik. Më poshtë, po rendisim vendgjetjet më të rëndësishme dhe më të afërta me sheshin në fjalë, të cilat na japin një pamje të qartë të potencialit që paraqet zona.

Nr. 1. Afërsisht 186 m gjendet muri i fortifikimit të antikitetit të vonë dhe mesjetar⁸ (**Fig. 12, nr.1**). Ky mur gjendet në një disnivel që ka luajtje, si pasojë e faktit që ngjitet në shpatin e kodrës. Në pikën më të afërt gjendet me një disnivel prej më shumë se +6 m lartësi në krahasim me sheshin e kërkuar.

Nr. 2. Afërsisht 127 m gjendet gërmimi i realizuar në vitin 2007 nga Adrian Anastasi (**Fig. 12, nr.2**), ku u identifikua një rrugë procesuale dhe disa varre⁹. Ky shesh gjendet në një disnivel prej mbi +20 m lartësi në krahasim me sheshin e kërkuar.

Nr. 3. Afërsisht 283 m gjendet gërmimi i realizuar në vitin 2011 nga DRKK Durrës (**Fig. 12, nr.3**), ku u identifikua një mur i ndërtuar me gurë¹⁰.

Nr. 4. Afërsisht 240 m (**Fig. 12, nr.4**) gjendet një shesh ku janë identifikuar gjurmë të një punishteje qeramike të shek. I para Kr.¹¹

⁸A.Baçe, Gj.Karaiskaj, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në kohën e vonë antike, *Monumentet*, 9, 1975, 5-26; Gj.Karaiskaj, Kalaja e Durrësit në mesjetë, *Monumentet* 13, 1977

⁹ Komunikim personal me autorin.

¹⁰ V.Stamo, Mbikëqyrje arkeologjike gjatë procesit të gërmimit në sheshin e ndërtimit, Lagje nr. 1, Rr.Epikadeve Durrës, 90-92, Raport Vjetor 2011, Agjencia e Sherbimit Arkeologjik, Tirane 2012.

¹¹E.Shehi, Contributo sulla topografia di Dyrrachium, *Journal of Ancient Topography* XVII (2007), 159-208.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

Nr. 5. Afërsisht 92 m gjendet një shesh gërmimi realizuar në vitin 2017 nga firma e linçecuar “AkeR” (**Fig. 12, nr.5**) ku u gjetën gjurmë muresh antike¹². Ky shesh gjendet në një disnivel prej afro +2.5 m lartësi në krahasim me sheshin e kërkuar.

Nr. 6. Afërsisht 170 m(**Fig. 12, nr.6**) janë gjetur dy varre monumentale te periudhës romake¹³. Kjo vendgjetje është në disnivel prej afro +8 m mbi sheshin e kërkuar.

Nr. 7. Afërsisht 18 m gjendet kisha ortodokse e Shën Gjergjit (**Fig. 12, nr.7**), ndërtuar pas vitit 1993. Kjo kishë gjendet në një disnivel prej afro +5 m mbi sheshin e kërkuar.

Nr. 8. Afërsisht 146 m (**Fig. 12, nr.8**) është gjetur një furrë për prodhimin e qeramikës¹⁴, që sot ruhet në Muzeun Arkeologjik Durrës. Kjo vendgjetje është në një disnivel prej afro -6 m në krahasim me sheshin e kërkuar.

Nr. 9. Afërsisht 80 m (**Fig. 12, nr.9**) gjendet një shesh gërmimi i realizuar në vitin 2017 nga firma e linçecuar “AKeR” ku u gjetën tre furra për prodhimin e qeramikës¹⁵. Kjo vendgjetje është në një disnivel prej afro -7 m në krahasim me sheshin e kërkuar.

Nr. 10. Afërsisht 62 m (**Fig. 12, nr.10**) gjendet një shesh i gërmuar nga ana e ASHA-s në vitin 2011 ku nuk janë evidentuar gjetje strukturash antike¹⁶.



¹² Përmbledhje e raportit dorëzuar në mbledhjet e KKA-së, Tiranë 2017.

¹³ F.Tartari, Arkitektura e disa varreve të shek. II-IV në Dyrrah, *Monumentet 15-16, 1978*, 65-72.

¹⁴ G.Pani, L.Papajani, Një furrë antike në Durrës dhe probleme të zhvendosjes së saj, *Monumentet 1*, 1986, 15-24.

¹⁵ Përmbledhje e raportit dorëzuar në mbledhjet e KKA-së, Tiranë 2017.

¹⁶ Raport Vjetor 2011, Agjencia e Sherbimit Arkeologjik, Tirane 2012

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

7. REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet e monitorimit arkeologjik për projektin
:‘RINDËRTIMI I GJIMNAZIT « GJERGJ KASTRIOTI »,
DURRËS

REKOMANDOJMË:

- Të kryhet gërmim i hapur për të sqaruar gjurmët e mozaikut dhe të linjave të murit të cilat u evidentuan gjatë procesit të monitorimit për ndërtimin e shkollës “Gjergj Kastrioti”
- Të miratohet koncepti i gërmimit arkeologjik në mbledhjen e radhës së Këshillit Kombëtar I Trashëgimisë Kulturore Materiale.
- Të pezullohen punimet nga kompania DION-AL sh.p.k, deri në përfundimin e gërmimitarkeologjik
-

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

8. BIBLIOGRAFIA

A.Baçe, Gj.Karaiskaj, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në kohën e vonë antikë, *Monumentet*, 9, 1975, 5-26.

Gj.Karaiskaj, Kalaja e Durrësit në mesjetë, *Monumentet* 13, 1977

V.Stamo, Mbikëqyrje arkeologjike gjatë procesit të gërmimit në sheshin e ndërtimit, Lagje nr. 1, Rr.Epikadeve Durrës, 90-92, Raport Vjetor 2011, Agjencia e Sherbimit Arkeologjik, Tirane 2012.

E. Shehi, Contributo sulla topografia di Dyrrachium, *Journal of Ancient Topography* XVII (2007),159-208.

F. Tartari, Arkitektura e disa varreve të shek. II-IV në Dyrrah, *Monumentet* 15-16,1978, 65-72.

G. Pani, L.Papajani, Një furrë antike në Durrës dhe probleme të zhvendosjes së saj, *Monumentet* 1, 1986, 15-24.

Raport Vjetor 2011, Agjencia e Sherbimit Arkeologjik, Tirane 2012

G.Valentini, *Actae Albanie Veneta*, vol. XVII, dok. nr. 3127qu, viti 1427.

C.ABAIE-REYNAL, E.SHEHI, Raporti fushates 2019 te projektit “Topografia e Epidamne-Dyrrhachion”, Arkivi IA.

H.BESTE, R.HAENSCH, H.VON HESBERG, E.SHEHI, F.TARTARI, “Inschriften und Fragmente einer Arkadenarchitektur au seiner Notgrabung am Hafen von Durrës (Epidamnos – Dyrrachium)”, *Archaeologischer Anzaiger* 2, 2015, 45-75.

A.HOTI, E.METALLA, E.SHEHI, Gërmime arkeologjike Durrës 2001-2003, *Candavia* 1, 2004, 139-172. M.KABO, Gjenezat e kënetave të ultësirës bregdetare (Në bazë të të dhënave historiko-arkeologjike), *Studime Gjeografike* 5, 1994, 179-203.

M.KABO, Mbi ndryshimin e rrjedhjeve të poshtme të lumenjve që përshkojnë ultësirën bregdetare gjatë epokës historike, *Studime Gjeografike* 4, 1990, 193.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

GJ. KARAIKAI, A.BAÇE, Kalaja e Durrësit dhe sistemi i fortifikimit përreth në kohën e vonë antike,

Monumentet 9, 1975, 5-33.

S.LELA, R.HALILI, E.SHEHI, Raport perfundimtar mbi sondazhet e kryera ne sheshin e ndertimit te subjektit ndertues “Blloshmi” shpk, ne *ASHA-Raport Vjetor* 2010, Tirane 2011, nr. 2, 14-15.

P.LUKA, Disa të dhëna për lëvizjet vertikale të kores së tokës në territorin e Durrësit nëpërmjet metodave gjeodezike, *Studime Gjeografike* 6, 1995, 271-283.

H.MYRTO, Raporti i germimit te vitit 1987 prane shkolles 16 Shtatori, Arkivi IA.

A.PAPA, Gjeologjia dhe geomorfologjia e pellgut dhe e shelfit shqiptar të Adriatikut, *Studime Gjeografike* 1, 1985, 96-116.

A.PAPA, L.PENGILI, Gjeologjia e shelfit detar te rajonit te Durresit, Ref. Ses. Shk. Inst. Naftes, Fier 1981.

S.SANTORO, B.SASSI, A.HOTI, ... ex continente visi... un probabile faro nel porto antico di Durazzo (Albania), në *Torre de Hércules: finis terrae lux. Simposio o sobre los faros romanos y la navegacion occidental en la antiguedad* (A. Coruña, junio 2008), *Brigantio* 20, 2009, 67-84.

E. SHEHI, Contributo sulla topografia di Dyrrachium, *Journal of Ancient Topography*, XVII, 2007, 159-208.

E.SHEHI, Rishikim mbi topografinë e Durrësit antik në dritën e të dhënave tëreja arkeologjiko-historike, *Iliria* XLI, 2017, 229-289.

KONCEPT : GERMIM ARKEOLOGJIK

Digitally signed by
Mariglen Meshini
Date: 2024.02.14
10:58:24+02'00'

